



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d**, të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe nenit 25, paragrafët 1, 2, dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 33.2, shkronja **a**, dhe nenit 34.1, shkronja **d**, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 27.09.2019, merr këtë

V E N D I M

PËR PLOTËSIM-NDRYSHIMIN E VENDIMIT, NR. 01.463/01-0101088/19, DT 03.05.2019, PËR KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS ME PRONËN E PALUAJTSHME NË PRONËSI PRIVATE

- I.** MIRATOHET Vendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit, nr. 01.463/01-0101088/19, dt. 03.05.2019, për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Ilir (Ajet) Sogojeva, Sabri (Ajet) Sogojeva, Ajet (Sami) Sogojeva, Albulena (Sami) Sogojeva dhe Agron (Sami) Sogojeva.
- II.** Sipas vendimit të cekur në pikën I, ndryshimi nënkupton:
 1. Ndryshohet pika II e vendimit, hiqet parcela 2674-1, pronë komunale, ZK Prishtinë dhe shtohet parcela 2759-1, pronë komunale, ZK Prishtinë.
 2. Propozimi për plotësim-ndryshimin e vendimit të cekur në pikën I të këtij vendimi, bëhet për shkak të lëshimit të një gabimi teknik, ku në vend të parcelës 2759-1 ZK Prishtinë, është shënuar parcela 2674-1, ZK Prishtinë.
- III.** Dispozitat tjera të Vendimit nr. 01.463/01-0101088/19 i dt. 03.05.2019 mbesin të pa ndryshuara.
- IV.** Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- V.** Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/01-239165/19, më 30.09.2019

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

